



N.P.L. PALLATI I RINISË SH.A.
Prishtinë – Kosovë, Luan Haradinaj, p.n.
e-mail:contact@pallatirinise.com

Në bazë të Ligjit Nr. 03/L-212 i Punës, Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, bazuar në Rregulloren Nr. 1/1373 të datës 22.11.2024 për Organizimin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës të N.P.L "Pallati i Rinisë" Sh.a dhe Plotësim ndryshimi i Rregullorës Nr.1/2017 të datës 28.10.2025 dhe Rregulloren për Marrëdhënien e Punës me Nr. 1/1338 data:14.11.2024 në N.P.L "Pallati i Rinisë" Sh.a, si dhe të Statutit të N.P.L "Pallati i Rinisë" Sh.a Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L Pallati i Rinisë Sh.a. – Prishtinë, me datë: 14.08.2026 nxjerrë këtë:

V E N D I M

- 1.**ANULOHE**T konkursi publik për pozitën e punës Kryetëknik për shërbime të mirëmbajtjes dhe të higjienës një (1) pozitë pune.
2. **Shfuqizohet** Vendimi me nr. 1/1578 të datës 14.07.2026 për themelimin e Komisionit për vlerësimin e pozitave sipas konkursit në pikën 1 të këtij vendimi.
3. **Obligohet** Zyra e Burimeve Njerëzore në zbatim të këtij vendimi të bëjë njoftimin publik për anulim të konkursit përfshirë edhe njoftimin e palëve eventuale të përfshira.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

A r s y e t i m

Më datë 10.07.2026, N.P.L. "Pallati i Rinisë" Sh.a. ka shpallur Konkursin Publik me nr. 1/1544 për plotësimin e një (1) vendi të punës për pozitën "**Kryetëknik për Shërbime të Mirëmbajtjes dhe të Higjienës**", ndërsa afati për aplikim ka përfunduar më datë 24.07.2026.

Pas përfundimit të procesit të verifikimit të aplikacioneve dhe shqyrtimit të ankesave, kandidati i vetëm i cili, pas përfundimit të procedurës së ankesave, ka rezultuar se i plotëson kriteret e përcaktuara në konkurs, nuk është paraqitur në testimin me shkrim të organizuar në kuadër të procedurës së rekrutimit.

Në përputhje me **Nenin 14 të Rregullores përkatëse**, testimi me shkrim përbën fazë të detyrueshme të procedurës së vlerësimit për kandidatët të cilët kanë kaluar me

sukses fazën e verifikimit paraprak të aplikacioneve. Pjesëmarrja në këtë fazë është kusht i domosdoshëm për vazhdimin e mëtejshme të procedurës së vlerësimit dhe përzgjedhjes.

Duke qenë se kandidati i vetëm që ka plotësuar kriteret e konkursit nuk është paraqitur në testimin me shkrim, nuk ekziston mundësi objektive dhe procedurale për vazhdimin e fazave të mëtejshme të rekrutimit, pasi faza e detyrueshme e testimit nuk është realizuar.

Për rrjedhojë, me qëllim të respektimit të procedurave të përcaktuara të rekrutimit, garantimit të transparencës, trajtimit të barabartë të kandidatëve dhe zbatimit të kriterëve të konkursit dhe akteve të brendshme në fuqi, **Konkursi Publik nr. 1/1544 për pozitën "Kryetëknik për Shërbime të Mirëmbajtjes dhe të Higjienës" anulohet.**

Me anulimin e këtij konkursi, procedura e rekrutimit për pozitën e lartcekur konsiderohet e përfunduar pa përzgjedhjen dhe emërimin e kandidatit.

Në rast se pozita e lartcekur vazhdon të jetë e nevojshme për funksionimin dhe mbarëvajtjen e veprimtarisë së N.P.L. "Pallati i Rinisë" Sh.a., ajo mund të rishpallet në një procedurë të rekrutimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e brendshme të ndërmarrjes.

Këshilla juridike : Kundër këtij Vendimi pala e pakënaqur ka të drejtë ankesë në Komisionin e Ankesave, në afat prej 7 ditëve , nga dita e pranimit të vendimit.

Kryeshefi Ekzekutiv i N.P.L Pallati i Rinisë Sh.A.-Prishtinë

Shpend Bilalli

Vendimi u dërgohet:

- Arkivit të N.P.L Pallati i Rinisë Sh.a;
- Zyrës së Burimeve Njerëzore;
- Anëtarëve të Komisionit Vlerësues